




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KRYEËSË ANTIKORRUPSIONIT AGENCIJA ZA VARNOST IZVARNOSTI AND THE KEY OF THE AGENCY	
Dep. DPK/OMP	Nr. Prot. 03-3871/13
Dep. 02	Prot. no. 14.11.2013
Nr. flet. 02	D. nr. 14.11.2013
Pro. llogos	Çështje
Nr. pages	Data



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.475-05/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje , me gjyqtarin Gjimshit Galushi , dhe procesmbajtësen Nexhla Vebiqi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Lulzim Kabashi nga Prizreni , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe neni 9 , të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e në bazë të neni 195 të LMK-së , me datën 16.10.2013 merr këtë :

A K T V E N D I M

I pandehuri Lulzim Hisen Kabashi , i lindur me 15.02.1971, në fsh.Korish KK Prizren, me vendbanim në Prizren, rruga Kuvendi i Arbërit nr.11

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse , sipas kërkesës së Agjencionit , e si Zyrtarë i lartë publik – deputet në asamble komunale në Prizren , nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë dhe prejardhjen e saj , pranë Agjencisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (deri më 31.03.2012) , edhe pse ka qenë i obliguar ,

- me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas neni 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e për këtë , duke aplikuar neni 9 të LMK-së ,

D Ë N O H E T

Me gjobë në lartësi prej 350 (treqind e pesëdhjetë)Euro .

I pandehuri obligohet që denimin e shqiptuar me gjobë , ta paguajë në afat prej 15 ditëve , nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi . Poqese këtë nuk e bën në afatin e caktuar , atëherë gjoba e shqiptuar do të zavendosihet me burgim , duke llogaritur 20 euro për një ditë burgu , kurse në afatin e njëjtë në emër të shpenzimeve gjyqësore, do të paguajë shumën prej 5 (pesë) euro, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm .

